

**URDHËR**  
**Nr. 69, datë 22.1.2025**

**PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në bazë të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 19, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar;

**URDHËROJ:**

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të parashikuara në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, znj. Llambriola Misto, sekretar i përgjithshëm.

2. Delegimi i kompetencave të parashikuara në pikën 1 të këtij urdhri, bëhet për të gjitha kompetencat për të cilat lejohet delegimi, sipas nenit 19, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e këtij urdhri.

4. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri sekretari i përgjithshëm, znj. Llambriola Misto, si dhe administrata e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**  
**Blendi Gonxhja**